



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Komisioni i Përhershëm i Mirëqenies Sociale Barazisë Gjinore Mosdiskriminimit dhe të Drejtave të Njeriut

Nr. 2023 prot.

Fushë-Arrëz, më 24. 01. 2025

PËR : KËSHILLIN E BASHKISË

FUSHË-ARRËZ

Lënda: Relacion i Komisionit të Përhershëm të Mirëqenies Sociale Barazisë Gjinore Mosdiskriminimit dhe të Drejtave të Njeriut për projekt/vendimin “Miratimi i listës emërore të përfituesve për përmirësimin e banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara” i cili që do t’i paraqitet Këshillit të Bashkisë për shqyrtim në mbledhjen e tij të datës 27.01.2025.

Ne zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqerisjen vendore”, i ndryshuar, Rregullores për Funksionimin e Këshillit të Bashkisë, Komisioni i Përhershëm i Mirëqenies Sociale, në mbledhjen e datës 24.01.2025 me pjesëmarrjen e anëtareve: Tereze Dema, Franc Doda dhe Pavlin Qafa, mori në shqyrtim projektin për listat emërore të përfituesve për përmirësimin e banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara

Anëtares e Komisionit janë njohur me projektin përmes materialit shkresor, ndërkohë në mbledhjen e komisionit, shpjegimet i dha Drejtoresha e Emigracionit e Çështjeve Sociale, zj.Sidorela Katroshi, e cila shpjegoi se:

Bazuar në Ligjin nr.22/2018, "Për Strehimin Social", Ligjit 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, VKM :362 date 29.05.2019, “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe menyren e llogaritjes së tij”, VKM Nr.384, date 12.06.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, VKM Nr.459 datë 03.07.2019 "Për rregullat për administrimin e kërkesave të njësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin", urdhërit të Kryetarit të Bashkisë nr.11 datë 07.01.2025 për "Ngritjen e Komisionit të Strehimit për vitin 2025", me propozim të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz dhe Komisionit të Strehimit për vitin 2025.

Familjet e propozuara sipas kriterëve të përzgjedhjes neni 16 i ligjit 22/2018 "Për Strehimin Social" për përfitimin e subvencionimit të qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit:

1. K/familjar, banues ne Fushë-Arrëz, nuk disponon banesë ne pronësi, perbërja familjare jeton vetem, eshte pensionist;
2. K/familjar, banues ne Fushë-Arrëz , trajtohet me ndihme ekonomike ose jo.

Te dhenat e mesiperme sipas Relacionit te paraqitur nga zyra perkatese

Anëtarët e komisionit u shprehen njëzëri per dakordesine duke qene se ky projekt iu vjen ne ndihme familjeve ne nevojë, projekt ky i bere per here te pare nga ana e zyrave te bashkise Fushe-Arrez per komunitetin sipas ligjit perkates ne fuqi.


Anëtarët e komisionit, me shumicë votash, ranë dakort me projektin për për listën emërore të përfituesve të subvencionimit me qira per vitin 2025 sipas listes emërore të përfituesve të subvencionimit me qira te paraqitur dhe kërkuan miratimin e tij nga Këshilli Bashkiak në mbledhjen plenare te dates 27.01.2025 duke kërkuar edhe mendime dhe propozime të tjera të këshilltarëve.

Duke kërkuar bashkepunimin tuaj!

Franc Doda



Pavlin Qafa



Tereze Dema